



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2019:127749
Datë: 24.06.2024
Numri i dokumentit: 05852360

C.nr.818/2023

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË - DEGA RAHOVEC - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Betim Behluli, me bashkëpunëtorin profesional Armond Qmega, në çështjen kontestimore të paditësit D.Z, nga Prizreni, të cilin e përfaqëson A.K, avokat nga Prizreni, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, kundër të paditurës K në Gjakovë, të cilën e përfaqëson A.M, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, me bazë juridike, kompensim i shpenzimeve të transportit, pas mbajtjes dhe përfundimit të shqyrtimit kryesor dhe zbatimit të provave, më 20.06.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET në tërësi si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit D.Z, nga Prizreni, me të cilën ka kërkuar që të “detyrohet e paditura K, të kompenzoj shpenzimet e transportit të paditësit në shumën ditore prej 4 €, në relacionin Prizren – Rahovec dhe anasjelltas, për ditët e prezencës në punë për periudhën 14.01.2016 deri me datë 13.05.2020, derisa paditësi ka punuar te e paditura në Nëndistriktin e Rahovecit, dhe atë: për vitin 2016, 197 ditë punë x 4 € = 788 €, për vitin 2017, 203 ditë punë x 4 € = 812 €, për vitin 2018, 193 ditë punë x 4 € = 772 €, për vitin 2019, 220 ditë punë x 4 € = 880 €, për vitin 2020, 48 ditë punë x 4 € = 192 €, gjithsej për 861 ditë të punës, në shumë të përgjithshme prej 3,444.00 €, me kamatë ligjore, nga dita e ushtrimit të padisë e deri te pagesa definitive, si dhe shpenzimet e procedurës në shumën prej 676,00 €, të gjitha këto në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimit të aktgjykimit, me kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi D.Z, nga Prizreni, ka ushtruar padi kundër të paditurës K për shkak të ndalimit të kushteve të punës dhe kompensimeve të udhëtimit.

Sipas kësaj çështje juridike janë caktuar disa seanca të shqyrtimit kryesor në të cilën janë paraqitur përfaqësuesi i autorizuar i paditësit Av. A.K dhe e autorizuar e të paditurës A.M.

Përfaqësuesi i autorizuar i paditësit avokati A.K, gjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, fillimisht në padinë e parashtruar me datë 29.03.2018, paditësi ka kërkuar që të anulohet njoftimi i të paditurës të datës 13.01.2016, për transferim nga Distrikti i Prizrenit nën Distriktin e Rahovecit si dhe të bëhet pagesa e shpenzimeve të transportit. Duke pasur parasysh se seanca gjyqësore nga Gjykata Themelore e Prizrenit, nuk ishte caktuar deri me datën 14.07.2021, e paditësi ndërkohë me datë 06.07.2020, është pensionuar në parashtrësën e datës 07.12.2020, është precizuar kërkesa dhe

është kërkuar vetëm kompensimi i shpenzimeve të transportit të paditësit. Paditësit ndërrimi i vendit të punës nga e paditura ishte bërë pa vullnetin e tij me pretekst se në rast se nuk e pranon transferin atëherë do të ndërprehet marrëdhënia e punës edhe pse paditësi në atë kohë kishte rreth 41 vjet përvojë pune dhe përkeqësim të gjendjes shëndetësore. Paditësi pas transferimit për shkak të përkeqësimit të dukshëm të shëndetit i cili fakt është vërtetuar nga institucionet e specializuara shëndetësore në vazhdimësi i është drejtuar të paditurës dhe ka kërkuar të kthehet në Distriktin e Prizrenit mirëpo asnjëherë nuk janë marrë parasysh kërkesat e tij. Për këto fakte janë parashtruar provat si në padi ashtu edhe në procesverbalin e seancës gjyqësore të datës 14.07.2021, të mbajtur në Gjykatën Themelore në Prizren. Duke marrë parasysh rrethanat e lartcekura paditësi parashtron kërkesën për kompensim të shpenzimeve të transportit në shumën ditore prej 4 € në relacionin Prizren - Rahovec dhe anasjelltas, duke llogaritur prej datës 14.01.2016, kur është transferuar nën Distriktin e Rahovecit e deri me datë 13.05.2020 kur ka përfunduar kontrata e punësimit me të paditurën në bazë të marrëveshjes së arritur mes palëve. Me gjithë kërkesën e paditësit drejtuar K-it, për dhënien e vërtetimit për ditët e punës që përfshijnë periudhën kohore deri sa ka punuar nën distriktin e Rahovecit, nga ana e K it, nuk ka pasur gatishmëri për këtë, andaj i propozojmë gjykatës ta marrë sipas detyrës zyrtare këtë dokument nga e paditura në kuptim të nenit 332 të LPK-së. Në plotësim të procedurës së provave parashtrorjme kartelën e punës së paditësit në K dhe K, marrëveshjen për ndarjen dhe lirim nga përgjegjësia të lidhur mes paditësit dhe të paditurës të datës 15.05.2020, vërtetimin e M në Prizren lidhur me periudhën e udhëtimit Prizren Rahovec dhe anasjelltas. E paditura ndërrimin e vendit të punës të paditësit nga distrikti i Prizrenit në nëndistriktin e Rahovecit kishte bërë pa vullnetin e tij me pretekst se në rast se nuk e pranon transferin atëherë do të ndërprehet marrëdhënia e punës edhe pse paditësi kishte në atë kohë rreth 41 vjet përvojë pune dhe keqësim të dukshëm të shëndetit dhe që ishte në kundërshtim me nenin 17 të marrëveshje së përgjithshëm kolektive. Paditësi pas transferimit për shkak të përkeqësimit të gjendjes shëndetësore i cili fakt është vërtetuar nga institucionet shëndetësore të specializuara në vazhdimësi është drejtuar të paditurës dhe ka kërkuar të kthehet në Distriktin e Prizrenit, mirëpo asnjë herë nuk janë marrë parasysh kërkesat e tij. Në periudhën e viteve 2016-2020, deri sa paditësi ka punuar nën Distriktin e Rahovecit i njëjti ka udhëtuar çdo ditë punë në relacionin Prizren-Rahovec dhe anasjelltas dhe e paditura nuk ka kompensuar shpenzimet e transportit. Andaj i propozoi gjykatës që kërkesëpadinë e precizuar të paditësit ta aprovoj në tërësi si të bazuar. Shpenzimet procedurale u kërkuar sipas OAK-së.

E autorizuar e të paditurës A.M, gjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë përgjigjes në padi, duke theksuar se i padituri me paditësin kanë pasur kontratën me numër 2411/8603, në të cilën kontratë paditësi ka pranuar të gjitha të drejtat dhe obligimet që dalin nga kjo kontratë, në këtë kontratë paditësi është pajtuar edhe me kushtet e kontratës mbi vendin dhe lokacionin ku aktualisht ka qenë i punësuar paditësi, kontrata e punës ka qenë e lidhur nën vullnetin e të dyja palëve në pajtueshmëri me dispozitat e Ligjit të Punës, andaj konsiderojnë se kërkesa lidhur me kompensimin e shpenzimit të transportit është e pabazë pasi që paditësi është pajtuar me kontratën dhe vendin në të cilin ka qenë i punësuar, pavarësisht se i njëjti gjatë detyrave të punës në Distriktin e Prizrenit, ka pasur disa vërejtje lidhur me sjelljen dhe performancën e dobët në punë e paditura përkundër të gjitha shkeljeve që janë konfirmuar dhe shqiptuar ndaj paditësit përsëri e ka trajtuar në mënyrën më të mirë duke i ofruar gjithmonë alternativa në mënyrë që i njëjti të rregullojë sjelljen dhe ti respektojë detyrat e punës së tij. Pas administrimit dhe shqyrtimit të provave të lartcekura nuk u vërtetua baza dhe lartësia e kërkesëpadisë përkundrazi përkundër faktit se i padituri kohë pas kohe në vazhdimësi tek e paditua ka shfaqur sjellje të këqija ku në bazë të sjelljeve ka pasur të shqiptuara disa vërejtje si verbale ashtu edhe me shkrim përkundër këtyre fakteve e paditura me paditësin ka pasur kontratën me nr. 2411/8603 në të cilën kontratë paditësi ka pranuar të gjitha të drejtat dhe

obligimet që dalin nga kjo kontratë, në këtë kontratë paditësi është pajtuar edhe me kushtet e kontratës mbi vendin – lokacionin ku ka qenë i punësuar paditësi theksoi se kontrata e punës ka qenë e lidhur me vullnetin e plotë të dyja palëve në pajtueshmëri me dispozitat të Ligjit të Punës, andaj konsiderojnë se kërkesa lidhur me kompensimin e shpenzimit të transportit është e pa bazë duke marrë për bazë se paditësi është pajtuar me kontratën dhe vendin në të cilin ka qenë i punësuar pavarësisht detyrave të punës në Distriktin e Prizrenit, ku ka pasur disa vërejtje lidhur me sjelljen dhe performancën e dobët i njëjti përsëri është trajtuar në mënyrë më të mirë duke i ofruar alternativa në mënyrë që të rregullohet sjellja dhe të respektohen detyrat e punës shtojnë dhe faktin se paditësi me asnjë provë materiale nuk ka arritur të vërtetoj bazën apo lartësinë e kësaj kërkesëpadie, andaj i propozoi gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj në tërësi si të pa bazuar si dhe ta obligoj paditësin në shpenzimet procedurale.

Për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, gjykata ka bërë administrimin e këtyre provave: Raportet mjekësore i P.Gj në Prishtinë të datës 08.02.2003, epikrizës të Spitalit Regjional të Gjakovës, i Qendrës Mjekësore në Rahovec, e datës 13.10.2016, i Spitalit të Përgjithshëm në Prizren, i datës 14.10.2016, i Spitalit të Përgjithshëm në Prizren, i datës 18.10.2016, i Institutit të Mjekësisë së Punës në Obiliq të datës 03.03.2017, i Spitalit M H i datës 07.10.2017; Kuponave fiskal dhe bileta e autobusit të lëshuar nga M si dhe vërtetimi i lëshuar nga M; Komunikimet në me të paditësit dhe të paditurës lidhur me kërkesën e tij dhe nderimit të vendit të punës dhe transferimin e tij nga Distrikti i Prizrenit në Distriktin e Rahovecit; Kontrata e punës 14.01.2016; Vendimi për transferimin e paditësit i datës 01.10.2014; vendimi për suspendimin – largimin e përkohshëm nga puna e datës 01.07.2015; Raportet e hyrje-daljeve në punë nga viti 2016 deri në vitin 2020; Kartela e punëtorit nr.2411 në K dhe në K Marrëveshje për ndarjen dhe lirim nga përgjegjësia e datës 15.05.2020.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse, provave të nxjerra në kuptim të nenit 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK) dhe me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar.

Me administrimin e raporteve mjekësore, gjykata e ka vërtetuar faktin se paditësi ka kryer operim të hernisë diskale.

Me administrimin e kuponave fiskal dhe bileta e autobusit të lëshuar nga M Prizren si dhe vërtetimi i lëshuar nga M, gjykata vërtetoi faktin se çmimi në relacion Prizren - Rahovec, dhe anasjelltas.

Me administrimin e kontratës së punës nr.2411/8603, të datës 14.01.2016, gjykata vërtetoi faktin se paditësi D.Z, nga Prizreni, me të paditurën K, kanë lidhur kontratë në kohë të pacaktuar, në pozitën Shkyçës.

Me administrimin e vendimit të datës 01.10.2014, gjykata vërtetoi faktin se paditësi është shpallur përgjegjës për keq sjellje – shkelje – humbja po dështimin në sigurimin e informatave të K-it, nga neni 6 par. 6.1, nën par (f). Për keq sjellje – shkelje të detyrave paraprahe të përmendurit i shqiptohet masa e vërejtjes me gojë.

Me administrimin e vendimit për suspendimin – largimin e përkohshëm nga puna nr. 5240 të datës 01.07.2015, gjykata vërtetoi faktin paditësi D.Z, me nr. të punës 2411, suspendohet – largohet përkohësisht nga marrëdhënia e punës me datën 01.07.2015.

Me administrimin e Raporteve të hyrje-daljeve në punë nga viti 2016 deri në vitin 2020, gjykata vërtetoi faktin se për periudhën e kërkuar paditësi ka prezantuar në punë.

Me administrimin e Njoftimit mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës me numër protokollit 1386 të dt. 02.05.2013, të lëshuar nga Kryeshefi Ekzekutiv, gjykata vërtetoi faktin se nga ana e të paditurës është vlerësuar se ekziston baza e mjaftueshme faktike se paditësi D.Z ka bërë shkelje disiplinore nga neni 70 pika 1.61 të Ligjit të Punës në Kosovë, si dhe nenit 5 pika I të Rregullores së Brendshme të Kompanisë mbi përgjegjësinë Disiplinore të Punëtorëve, andaj me kompetencë të plotë të ekzekutimit të masave disiplinore nga neni 70 pika 3 të Ligjit të Punës në Kosovë, konform fakteve të argumentuara si më lartë, si dhe faktin se paraprakisht ka qenë i dënuar për shkelje të lehta disiplinore, i është shqiptuar masa disiplinore ndërprerje e marrëdhënies së punës.

Pas vlerësimit të provave të administruara, të ofruara nga palët ndërgjyqëse, gjykatës i rezultoi se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar te e paditura, i caktuar në vendin e punës Shkycës – Nën Distriktin, Rahovec. Pretendimet e paditësit që të detyrohet e paditura K – Prishtinë, të kompenzoj shpenzimet e transportit të paditësit në shumën ditore prej 4 €, në relacionin Prizren – Rahovec dhe anasjelltas, për ditët e prezencës në punë për periudhën 14.01.2016 deri me datë 13.05.2020, derisa paditësi ka punuar te e paditura në Nëndistriktin e Rahovecit, gjykata nuk e morri për bazë, ngase në bazë të kontratës nr.2411/8603, të datës 14.01.2016, paditësi D.Z, nga Prizreni, me të paditurën K, të njëjtit kanë lidhur kontratë në kohë të pacaktuar, në pozitën Shkycës, dhe në asnjë nen të kontratës nuk është paraparë që të njëjtit ti paguhen shpenzimet e transportit, sepse paditësi është pajtuar me kontratën, respektivisht detyrën dhe vendin e punës në të cilën ka qenë i punësuar.

Gjykata ka bërë vlerësimin edhe të provave të tjera të administruara dhe të përmendura më lartë, por vlerësoi se të njëjtat janë pa ndikim në zgjidhjen meritore të kësaj çështje juridike.

Nga të cekurat u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 452.4 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC
C.nr.818/2023, më 20.06.2024

Bashkëpunëtor profesional
Armond Qmega

Gjyqtari
Betim Behluli

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, ankesa paraqitet nëpërmjet të kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit, Divizioni Civil në Prishtinë